



[Handwritten signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:048277
 Datë: 31.08.2018
 Numri i dokumentit: 00111182

P.nr.2730/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.729-5/2016 të datës 30.10.2017, në praninë e prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, dhe të pandehurit [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më dt. 10.08.2018, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 20.08.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt. 07.05.2016, rreth orës 22:00, në rrugën regjionale Ferizaj - Gjilan, saktësisht në fshatin Dardani, derisa ishte duke vozitur me veturën e udhëtarëve të markës "Daimler

2", ngjyrë të kaltërt me targa [REDAKTUAR], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që humb kontrollin mbi timon kalon në anën e majtë jashtë rrugës duke i dëmtuar pronat rrethojat e oborrit dhe e këput shtyllën elektrike me pjesën anësore të anës së djathtë e përplasat në livadh ku kishte lënë gjurmë të bartjes rreth 31 metra, me ç'rast përveq dëmeve materiale dhe lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 16.09.2017, pësojnë pasagjerët [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 7, 8, 9, 17, 21, 41, 73, 74, 85 dhe 86 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPK-së, të pandehurin i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

- I pandehuri u njoftua se vepra e fillë përbën veprë penale, veprë e dëmshme dhe e rrezikshme, si dhe nëse i njëjti prapë kryen veprë të fillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.
- Të dëmtuarit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzet/ si dhe shpenzimet e procedurës penale /ekspertiza e komunikacionit shumën prej 40.88 Euro /katërdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, ekspertiza mjeko – ligjore shumën 20 Euro /njëzet/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, të ligjit Nr. 05/L-036 për kompensimin e Viktimave të Krimet, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.729-5/2016 të datës 30.10.2017 ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.08.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuzat për të gjitha pikat e saj, dhe është e vetëdijshme për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale, ndihet thellë i penduar, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla penale do të kem kujdes në trafik, të dëmtuarit i kam familje, mirëpo ka ndodhur nga pakujdesia, jam i papunë dhe i propozoj gjykatës që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton vërejtje gjyqësore.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësore, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajtit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: ekspertiza mjeko ligjore e dt. 16.09.2017, ekspertiza e komunikacionit e dt. 11.07.2017, raporti i aksidentit me nr. 2016-CFT-253 i datës 07.05.2016, deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt. 08.05.2016 si dhe fotografitë dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto të mbledhura në hetuesi;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: me dt. 07.05.2016, rreth orës 22:00, në rrugën regjionale Ferizaj - Gjilan, saktësisht në fshatin Dardani, derisa ishte duke vozitur me veturën e udhëtarëve të markës "Daimler Benz", ngjyrë të kaltërt me targa [REDAKTUAR] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që humb kontrollin mbi timon kalon në anën e majtë jashtë rrugës duke i dëmtuar pronat rrethojat e oborrit dhe e këput shtyllën elektrike me pjesën anësore të anës së djathtë e përplasat në livadh ku kishte lënë gjurmë të bartjes rreth 31 metra, me ç'rast përveq dëmeve materiale dhe lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 16.09.2017, pësojnë pasagjerët [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikur publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të pandehurin Adnan Lalinovci të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe atë veprimet e

0704010711

dërligjishme të kryera nga i pandehuri me çka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të pandehurit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, kurse si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi bazë të këtyre rrethanave i shqiptoj vërejtje gjyqësore si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2730/17, me dt. 20.08.2018

Zyrtare ligjore,
Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.